

Udhëzimet për pjesëmarrësit me standë në Konferencën e organizuar nga Fëmijë në Fokus- 2019.

Konferenca Kombëtare e shërbesave Ungjillore për trevat shqipfolëse organizohet për të tretin vit radhazi në Shqipëri nga organizatorët “Fëmijë në Fokus”. Për këtë vit Konferenca Kombëtare do të organizohet në datat 3-4 Tetor 2019 në Eden” Park, Dajës, Tiranë. Për të gjitha organizatat të cilat do të marrin pjesë me një standë për të bërë të njohur punën/shërbesën e tyre për pjesëmarrësit duhet të respektojnë disa udhëzime dhe rregulla funksionimi si më poshtë vijojnë:

1. Regjistrimi dhe Kostoja e pjesëmarrjes me standë.

- Çdo organizatë pjesëmarrëse duhet të regjistrohet paraprakisht online në link; <https://forms.gle/trh16WaoGLajPoR37>.
- Çdo organizatë pjesëmarrëse ka një pagesë prej 2.000 lekësh të reja për një standë. Vini re; Kjo vlerë nuk përfshin koston e personelit tuaj.
- Pagesa do të bëhet ditën e konferencës tek këndi i arkës së konferencës nga ora 10:30-11:15.
- Afati i regjistrimit për standat është deri në datë 20 shtator 2019 ora 14:00.

2. Vendosja dhe hapsira:

- Standat e organizatës tuaj do të vendosen në sallën kryesore, aty ku organizohet edhe konferenca, përballë me panelin kryesor. Kjo krijon mundësi maksimale për dukshmërinë e organizatës, si dhe mundësi për përfaqësuesit tuaj që do të qëndrojnë në stenda, të mos humbasin asnjë moment nga konferenca dhe fjalimi i folësve.
- Vendi i organizatës tuaj (stendave) do të jetë i parapërcaktuar më parë nga organizatorët e eventit të konferencës.
- Orari i hapjes së sallës për përgatitjen e stendave është: 08:30 ditën e parë, datë 3 dhe duhet të jetë përfunduar në orën 09:00. Ata të cilët janë regjistruar në sesionin e parë me Bill Wilson, takimi fillon në orën 09:00, ndërsa të gjithë të tjerët do të kenë mundësi për një kohë lutje dhe kafe në katin e dytë të sallës.
- Orari i mbylljes është midis orë 16:45-17:30 Datë 4, dita e dytë e konferencës.

3. Organizimi dhe pamja e standës:

- Çdo standë organizate ka të drejtë të vendosë brenda hapsirës së saj, përcaktuar më parë, të gjitha materialet në mënyrë të organizuar dhe etike duke ju përputhur kushteve dhe ambjentit të konferencës.
- Të gjitha materialet e panevojme/rezervat duhet të vendosen në pjesën e brendshme të tavolinës, në mënyrë që të mos duken për syrin e vizitorëve/ të ftuarve.
- Të siguroni që materialet tuaja si; kabuj, priza, kuti etj të mos krijojnë pengesa ose rrezik për pjesëmarrësit.
- Personi përfaqësues për standën e organizatës duhet të qëndrojë në brendësinë e tavolinës ekspozuese, ulur në një karrike ose duke qëndruar në këmbë.

4. Çfarë nuk sigurojnë organizatorët?

- Laptop, ose ekran prezantues në tavolinën e ekspozimit
- Priza/zgjatues brenda hapsirës tuaj, të cilat mund t'ju nevoiten për të përçaruar energji në paisje të ndryshme që ju mund të keni.
- Aksesori ndihmës për të fiksuar materialet, stendat, ngjitës etj.
- Stilolapsa, bllok shënimesh, aparat fotografik, etj.
- Bateri/ karikues për pajisje/ celularë/ internet mjaftueshëm, etj.
- Drita 'Spot'

5. Çfarë sigurojnë organizatorët?

- Prezantimin e organizatës tuaj në hapjen e konferencës nga organizatorët*.
- Vend dhe hapsirë të sigurt për ekspozimin e stendës tuaj në sallën e konferencës. Hapsirën fizike minimalisht 7.60 m² për çdo organizatë duke përfshirë vendosjen e stendave, qëndrimin e personit dhe tavolinën e ekspozimit.
- Një tavolinë ekspozimi ka një përmasë prej 180x50 cm dhe lartësi 77 cm.
- Hapsira e aksesueshme në krahët e tavolinës tuaj do të jetë rreth 1,5 m në një krah (hapsirë e mjaftueshme për një baner të organizatës tuaj) dhe 50 cm hapsirë kalimi në krahun tjetër. (Dmth. hapsirë e përbashkët kalimi 50 cm në të dy krahët e tavolinës)
- Sigurisht, hapsirë të mjaftueshme në pjesën e përparme dhe të pasme të tavolinës tuaj.
- Mbulesa për çdo tavolinë ekspozimi që ju do të përdorni.
- Sigurimi i energjisë elektrike në afërsi të stendës tuaj.
- Karrige për personin përfaqësues të stendës.
- Printimin e logos së organizatës tuaj*.
- Ndriçimin e mjaftueshëm në sallë.
- Reklamimi i punës tuaj në librushkën e konferencës*.

6. Reklamimi në Librushkën e Konferencës

- Çdo organizatë do të ketë për të paraqitur informacion për punën/shërbesën e saj në librushkën e konferencës "Fëmijë në Fokus" 2019. Hapsira që do të zërë informacioni i organizatës tuaj do të jetë ½ e sipërfaqes së një faqe të saj. Ju do të keni mundësi të keni një kopje prej saj. *Plotësoni formularin online për mbledhjen e informacionit të organizatës tuaj në link; <https://forms.gle/urJPctY1fmhaBeZD8>

7. Personi i kontaktit.

- Personi përgjegjës për organizimin dhe vendosjen e stendave për këtë Konferencë do të jetë Manjola Lushka. Për çdo informacion shtesë ose paqartësi kontaktoni në adresën e e-mailit përmes FNF ose direkt në spark.manjola@gmail.com. Përndryshe në numrin e celularit + 355 69 60 06 131.

Kërkohet mirëkuptimi juaj:

1. Për ruajtjen e qetsisë, gjatë kohës së sesioneve kërkohet bashkëpunimi juaj për të mos reklamuar në stendë.
2. Organizatorët nuk mbajnë përgjegjësi në rast të humbjes ose ngatërimit të materialeve nga stendat tuaja, gjatë kohës së konferencës.